



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi
VENDIM
Nr. 218, Datë 11.10.2018

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 133, DATË 07.06.2018, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ÇAUSHI - ENERGJI” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË “PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” NR. 181, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 122, DATË 29.08.2012”

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 104, pika 4, gërma “b”; të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 07.06.2018, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Çaushi - Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës së “Prodhimit të energjisë elektrike” nr. 181, Seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.08.2012”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 133, datë 07.06.2018, pranoi kërkesën e shoqërisë “ÇAUSHI - ENERGJI” sh.p.k., për modifikimin e Licencës me nr. 181, Seria PV12K, për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec “Qafëzezë”, me fuqi të instaluar 400 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122 datë 29.08.2012, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja dijani e këtij vendimi, të depozitohet në ERE Lejen Mjedisore dhe Lejen e Shfrytëzimit të Ujrave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kW.
- Po ashtu në pikën 2 të vendimit sipërcituar është përcaktar se: “Në rastin e mospërbushjes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.”
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE ka përcjellë pranë subjektit shkresën nr. 312/1 Prot., datë 18.06.2018, “Njoftim vendimi” me anë të së cilës ka bërë më dije subjektin për vendimmarrjen me kusht të Bordit të ERE në lidhje me kërkesën e tij për modifikimin e licencës.
- Në vijim të kësaj korrespondence ERE me shkresën nr. 312/2 Prot., datë 28.06.2018, ka dërguar pranë subjektit “Çaushi Energji” sh.p.k vendimin nr. 133, datë 07.06.2018, sipërcituar.
- Po ashtu ERE me shkresën nr. 312/3 Prot., datë 24.08.2018, ka përcjellë pranë subjektit “Çaushi Energji” sh.p.k një “Kujtesë” me anë të së cilës ka kujtuar subjektin se afati i përmbushjes së kushtit në zbatim të Vendimit të Bordit të ERE nr. 133, datë 07.06.2018, përfundon në datën 28.09.2018 dhe gjithashtu detyrimin e subjektit për të depozituar në ERE, Lejen Mjedisore dhe

Lejen e Shfrytëzimit të Ujrave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kW.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në Vendimin e Bordit të ERE nr. 133, datë 07.06.2018, nga ana e subjektit “Çaushi Energji” sh.p.k, është depozituar shkresa e protokolluar në ERE me nr. 312/4 Prot., datë 24.09.2018, me anë të së cilës ky subjekt ka dërguar Lejen e përdorimit të rezervave ujore nr.12, datë 04.011.2009 e cila ka përfunduar vlefshmërinë e saj në datën 04.11.2014 dhe ka deklaruar se ka bërë aplikim për rinovimin e saj me shkresën nr. 1017 Prot., datë 20.09.2018, pranë Këshilli i Basenit Ujor Seman, ka likuiduar dhe tarifat përkatëse dhe pret miratimin nga ky Këshill.
- Subjekti “Çaushi Energji” sh.p.k, ka deklaruar në shkresën e tij se ka edhe një Leje Mjedisore të miratuar me Vendimin nr. 22, datë 24.08.2010 të Komisionit të shqyrtimit të kërkesave, e cila është e vlefshme dhe për periudhën aktuale pasi sikurse edhe vetë leja citon në pikë 6 të saj, ajo bëhet e vlefshme pasi veprimtaria licencohet nga institucioni përkatës. Vlen të theksojmë se Leja Mjedisore në pjesën “Specifikime teknike” pasqyron fuqinë prej 1000 kW, ndërkohë që fuqia që kërkon të ndryshojë subjekti “Çaushi Energji” sh.p.k, shkon në 1450 Kw.
- Spjegimet e dhëna dhe dokumentat e paraqitur nga ana e subjektit, nuk janë të mjaftueshme dhe konsiderohen një mungesë dokumentacioni thelbësor për vendimmarrjen finale të Bordit të ERE-s mbi këtë modifikim.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shfuqizimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 07.06.2018, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Çaushi - Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës së “Prodhimit të energjisë elektrike” nr. 181, Seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.08.2012”.
2. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Çaushi Energji” sh.p.k për modifikimin e licencës së Prodhimit të energjisë elektrike me nr. 181, Seria PV12K, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 122, datë 29.08.2012.
3. Shoqëria “Çaushi Energji” sh.p.k të depozitojë në ERE brenda 10 ditëve nga marrja dijani e vendimit, kartonin e licencës së lëshuar me kusht.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë OSHEE sha dhe MIE për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI